



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Kushtet dhe kriteret e themelimit, licencimit dhe fillimit të punës së institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional

NUMËR: 5/2007

DATË: 2.04.2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisë në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 5.2 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe nenit 8.3 dhe 11.3 të Ligjit të Arsimit Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1 Qëllimi

Më këtë Udhëzim administrativ përcaktohen kushtet dhe kriteret për themelimin dhe licencimin e Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (më tutje IAAP) publik dhe privat nga MASHT-i.

Neni 2 Themelimi

1. IAAP publik themelohet nga MASHT në konsultim me komunën, duke pasur parasysh nevojat e zhvillimit ekonomik dhe social në Kosovë.

2. IAAP privat e themelon personi juridik privat.

Neni 3

Kushtet dhe kriteret për themelimin e IAAP

Kushtet për themelimin e IAAP publik janë:

- a) kërkesa e Komunës me arsyetimin për nevojën e themelimit të institucionit;
- b) së paku dy paralele në klasën e X-të;
- c) kuadri i kualifikuar sipas programeve arsimore për fushat përkatëse;
- d) hapësira për zhvillimin e mësimi në klasë duhet të jetë $2m^2$ për nxënës, ndërsa kabinetet dhe laboratorët të jenë min. $2,5m^2$, punëtoritë min. $3,5m^2$;
- e) kabinetet, laboratorët, punëtoritë dhe pajisjet tjera teknike për zhvillimin e arsimit dhe aftësimi profesional varësisht nga programet që zhvillon shkolla;
- f) objekti shkollor me lokalet përcjellëse dhe oborr, si dhe
- g) fletën poseduese mbi pronësinë e shkollës.

Neni 4

Standardet

MASHT në bashkëpunim me Këshillin e Arsimit dhe Aftësimi Profesional (KAAP), do të përcaktojë standardet dhe normat të cilat do të zbatohen në shkollat profesionale të Kosovës, në afat prej gjashtë muajsh nga konstituimi i KAAP-it.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret për themelim dhe licencim të IAAP privat

1. Për ta marrë licencën IAAP privat, duhet ti plotësojë kushtet dhe kriteret e përgjithshme të përcaktuara nga MASHT-i në nenin 3 pikat (b,c,d,e,f, g) të këtij Udhëzimi administrativ.
2. Kushtet dhe kriteret e veçanta dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me themelimin dhe licencimin janë të përcaktuara me Udhëzimin administrativ të nxjerrë nga MASHT-i me nr 3/2003, si dhe me akte tjera nënligjore.

Neni 6

Përgjegjësitë e sigurisë dhe shëndetësisë

1. Komuna është përgjegjëse për sigurinë e nxënësve për IAAP publik, ku ata e realizojnë praktikën .
2. IAAP privat, është përgjegjës për sigurinë e nxënësve ku ata e realizojnë praktikën.

Neni 7
Praktika profesionale

1. Praktika profesionale realizohet në shkollë, në ndërmarrje apo në institucionet e aftësimit profesional, sipas marrëveshjes.
2. Praktika në ndërmarrjet dhe institucionet e aftësimit profesional duhet të bëhet me marrëveshje në mes të shkollës dhe kompanisë, me pëlqimin paraprak të MASHT.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

Agim Veliu, ministër